

[FAQJA PARE](#)[KALENDARI](#)[SPORTISTET](#)[PROJEKTET](#)[PARTNERE](#)[MARKETING](#)[IOC/EOC](#)

Faqja pare

KOKSH

- [Historik](#)
- [Presidenti](#)
- [Asambleja](#)
- [Anetaret e Komitetit Ekzekutiv](#)
- [Komisionet](#)
- [Departamentet](#)
- [Kontakt](#)
- [Kerko](#)

PROJEKTE

- [Faqja pare](#)
- [Kalendari](#)
- [Sportistet](#)
- [Projektet](#)
- [Partnere](#)
- [Marketing](#)

ZHVILLOHET KAMPIONATI I HAPUR MESDHETAR I ORIENTIMIT / TURI SHQIPERISE - MOC 2008 ORIENTEERING



2008 – Tour Albania



MEDITERRANEAN OPEN CHAMP IONSHIP ORIENTEERING
Greece – Albania - Italy



LAJMI I FUNDIT

[REZOLUTA E SEMINARIT TE DYTE MBI AUTONOMINE E LEVIZJES OLIMPIKE DHE SPORTIVE](#)
Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (IOC) organizoi më datë 12/02/2008 në Lozanë të Zvicrës Seminarin e dytë mbi

AKTIVITETE NDERKOMBETARE

- [Lojrat olimpike](#)
- [Lojrat Mesdhetare](#)
- [Lojrat Ballkanike](#)
- [EYOF](#)
- [Aktivitete Rajonale](#)

[IOC/EOC](#)

LEVIZ. OLIMP. SHQIPTARE

[Federatat](#)
[Shoqatat](#)
[Klubet](#)

CO SPONSOR GJENERAL



Tiranë, 25 Shkurt 2008

DEKLARATË PËR SHTYP ORIENTEERING – TANI EDHE NË SHQIPËRI

Në partneritet me *Parc World Tour*, Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar mori pjesë në realizimin e Projektit „**Sporti – Turizmi – Shkolla – Mjedisi**“, në kuadrin e Kampionatit Mesdhetar të Sportit të Orientimit, kampionat i cili mbledhi rreth tij Italinë, Greqinë dhe Shqipërinë. Në organizim ndihmoi edhe Klubi i Ecjes dhe Vrapimit Tiranë, me kryetar Suad Jegenin. Turi i Shqipërisë u zhvillua sot pranë Amfiteatrit të Liqenit Artificial të Tiranës, me pjesëmarrjen e rreth 100 sportistëve, kryesisht nga vendet Skandinave. E veçanta e këtij evenimenti me rëndësi për sportin shqiptar dhe promovimin e tij, ishte se në këtë Tur morën pjesë edhe katër sportistë shqiptarë, nga të cilët Edmond Bajraktari mori çmimin e parë për kategorinë e të rinjve. Në këtë aktivitet masiv që zgjati rreth 4 orë, ishte i pranishëm z. Stavri Bello, Sekretar i Përgjithshëm i KOKSH, i cili shprehu kënaqësinë e tij më të madhe në realizimin e këtij event për herë të parë në Shqipëri. Gjithashtu të pranishëm ishin edhe anëtarët e Komisioneve të KOKSH: “Femra dhe Sporti”, “Sporti për të

[Sporti për të gjithë](#)

AKADEMIA OLIMPIKE SHQIPTARE

[Struktura](#)
[Rregullorja](#)
[AOSH dhe IOA](#)
[Edukimi Olimpik](#)

ZYRA E SHTYPIT

[Newsletter](#)
[Pressrelease](#)
[Publikime](#)
[News](#)

Cili është mendimi juaj për faqen e re të KOKSH?

- Shumë mirë
 Mirë
 Mundësi për mirësimi

[Voto](#) [Results](#)

Sa i nevojshëm është Edukimi Olimpik në shkolla për formimin e përgjithshëm të fëmijëve?

- Shumë
 Mjaftueshëm
 Pak
 Nuk nevojitet

[Voto](#) [Results](#)

Gjithë" dhe Komisoni Sportistit. Ajo çfarë i dha një atmosferë akoma më të bukur këtij aktiviteti ishte pjesëmarrja e 20 vullnetarëve të rinj, nxënës të Liceut Artsitik të Gjuhëve të Huaja në Tiranë, për pjesëmarrjen e të cilëve falenderohet veçanërisht Drejtori i kësaj shkolle, z. Prelë Vata. Presidenti i veprimtarisë së Orientimit z. Gabriele Viale dhe Koordinatori Jorgen Mortenssen, në një intervistë për shtypin theksuan se zhvillimi i sportit të Orientimit edhe në Shqipëri përbën një hap më tej për këtë vend të bukur nga pikëpamja natyrore, por që duhet të dish ta shfrytëzosh, duke sjellë herë pas here sporte e rryma të reja, të cilat kontribuojnë pozitivisht në imazhin e sportit vendas kudo në botë. Në përfundim u shpërndanë certifikatat e çmimeve fituese, shoqëruar nga buqeta lulesh.

Dena Grillo

Zyra e Shtypit KOKSH



Nga aktiviteti



Shqiptarët pjesëmarrës



Vullnetarët

Next >

[Back]

Copyright © 2007 KOKSH

Dizenjuar nga [Cactus](#)